VENDIM
Nr. 58, datë 25.7.2017

NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	"	"
Fatmir Hoxha	anëtar i	"	"
Gani Dizdari	anëtar i	"	"
Besnik Imeraj	anëtar i	"	"
Fatos Lulo	anëtar i	"	"
Vitore Tusha	anëtare e	"	"

me sekretare Belma Lleshi, në datën 13.6.2017, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 29 Akti, që i përket:

KËRKUESE: Shoqëria "Alb-Canaj" sh.p.k.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Ministria e Energjisë dhe Industrisë

Shoqëria "Global Enterprise Group" sh.p.k.

Avokatura e Shtetit

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimit nr. 00-2015-1766 (132), datë 3.3.2015, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ); ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes, Vitore Tusha, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkueses, shoqërisë "Alb-Canaj" sh.p.k., që kërkoi pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, shoqërisë "Global Enterprise Group" sh.p.k. dhe Avokaturës së Shtetit, që kërkuan rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesja është person juridik që ushtron veprimtarinë e shfrytëzimit të mineralit të kromit sipas lejes minerare të shfrytëzimit nr. 481, datë 2.8.1999. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE), sot Ministria e Energjisë dhe Industrisë (MEI), pas kërkesës së bërë nga kërkuesja, ka vendosur me urdhrin e ministrit nr. 527, datë 16.7.2010, zgjerimin e lejes minerare të kërkueses dhe pasqyrimin e ndryshimit të sipërfaqes në regjistrin e lejeve minerare. Edhe subjekti i interesuar, shoqëria "Global Enterprise Group" sh.p.k., si person juridik i regjistruar, është pajisur me lejen minerare të shfrytëzimit nr. 1497, datë 10.9.2010. Nga një studim i kryer nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) ka rezultuar një mbivendosje e sipërfaqeve të dhëna për shfrytëzim kërkueses dhe subjektit të interesuar, shoqërisë "Global Enterprise Group" sh.p.k.

2. METE-ja, me urdhrin nr. 1003, datë 13.12.2011, ka ndryshuar sipërfaqen e lejes minerare që i është dhënë kërkueses duke e zgjeruar atë, ndërsa me urdhrin nr. 1004, datë 13.12.2011, ka revokuar lejen minerare të shfrytëzimit dhënë subjektit të interesuar, shoqërisë "Global Enterprise Group" sh.p.k. Këta dy urdhra janë kundërshtuar në gjykatë nga subjekti i interesuar, shoqëria "Global Enterprise Group" sh.p.k. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 6505, datë 11.6.2013,

ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes për mosparaqitje në gjykim të paditësit. Ky vendim është ankimuar nga kërkuesja në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila me vendimin nr. 162, datë 27.3.2014, ka vendosur mosshqyrtimin e çështjes dhe dërgimin e saj për kompetencë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë. Me vendimin nr. 3321, datë 9.9.2014, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur pushimin e gjykimit.

3. Në vijim, METE-ja, me urdhrin nr. 589, datë 21.6.2013, ka revokuar urdhrin nr. 1003, datë 13.12.2011, dhe me urdhrin nr. 590, datë 21.6.2013, ka shfuqizuar urdhrin nr. 1004, datë 13.12.2011. Këta urdhra janë bazuar në raportkontrollin e Departamentit të Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsion (DKBAA) nr. 165, datë 16.5.2013.

4. Kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me kërkesëpadi duke kërkuar anulimin e urdhrave nr. 589/2013 dhe nr. 590/2013 të METE-s, detyrimin e MEI-t të zbatojë urdhrat nr. 1003/2011 dhe nr. 1004/2011, si dhe sigurimin e padisë nëpërmjet pezullimit të zbatimit të urdhrave nr. 589/2013 dhe nr. 590/2013.

5. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 1763, datë 21.4.2014, ka vendosur pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë, konstatimin si absolutisht të pavlefshëm të urdhrave nr. 589 dhe nr. 590 të datës 21.6.2013, detyrimin e MEI-t të zbatojë urdhrat nr. 1003/2011 dhe nr. 1004/2011, si dhe rrëzimin e kërkesës për marrjen e sigurisë së padisë.

6. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 3094, datë 16.7.2014, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 1763, datë 21.4.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

7. MEI ka paraqitur në Gjykatën e Lartë kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 1763, datë 21.4.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, kërkesë e cila është pranuar nga Gjykata e Lartë me vendimin nr. 289, datë 11.9.2014.

8. Me vendimin nr. 00-2015-1766 (132), datë 3.3.2015, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (KAGJL) ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 1763, datë 21.4.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe vendimit nr. 3094, datë 16.7.2014, të Gjykatës Administrative të Apelit, si dhe rrëzimin e padisë.

II

9. Kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me kërkesë për konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, duke parashtruar si vijon:

9.1. Është cenuar parimi i gjykatës së caktuar me ligj nga KAGJL-ja, pasi vendimi nuk është mbështetur në provat e administruara gjatë gjykimit në shkallë të parë dhe në apel. Ky Kolegj ka tejkaluar kufijtë e kërkesave të parashtruara nga palët, në shkelje të parimit të disponibilitetit dhe në kundërshtim me parimet mbi të cilat mbështetet procesi gjyqësor civil dhe administrativ. Sipas kërkueses, procedura e konkurrimit për marrjen e lejes minerare, së cilës i është referuar në vendim KAGJL-ja, nuk përmendet fare si provë e administruar gjatë gjykimeve në shkallët më të ulëta. Po kështu, kërkuesja pretendon se kur ministri ka nxjerrë urdhrat nr. 589/2013 dhe nr. 590/2013, çështja ka qenë në proces shqyrtimi në Gjykatën e Apelit dhe asnjë organ i administratës nuk kishte të drejtë të shqyrtonte një mosmarrëveshje civile që ishte duke u shqyrtuar nga gjykata, bazuar në nenin 36 të Kodit të Procedurës Civile (KPC).

9.2. Është cenuar standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor, për shkak se vendimi i KAGJL-së është i paqartë dhe jologjik. KAGJL-ja nuk ka zbatuar dispozitat ligjore që ishin në fuqi në kohën kur janë nxjerrë lejet minerare për kërkuesen dhe subjektin e interesuar, "Global Enterprise Group" sh.p.k. Ajo ka mbajtur qëndrime kontradiktore, pa përmendur dispozitat ligjore ku referon paligjshmërinë e akteve administrative për të cilat shprehet në vendim.

10. *Subjekti i interesuar,* MEI, pretendon se kërkesa e paraqitur nga kërkuesja nuk përmban elemente të cenimit të të drejtave kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, duke parashtruar si vijon:

10.1. Vendimi i KAGJL-së është i mbështetur tërësisht në provat e administruara në dosjen gjyqësore dhe përbën një vendim të drejtë e të mbështetur në ligj. Ky Kolegj është shprehur për të gjitha kërkimet e parashtruara nga kërkuesja dhe e ka zgjidhur mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Me të drejtë, Gjykata e Lartë ka arritur në përfundimin se aktet administrative, objekt i gjykimit të themelit, janë akte të nxjerra konform ligjit nga organi kompetent administrativ.

10.2. Neni 36 i KPC-së nuk është shkelur, pasi në kohën kur janë nxjerrë urdhrat objekt i gjykimit të themelit, çështja që pretendon kërkuesja ishte pushuar për shkak të mosparaqitjes së palës paditëse. Pretendimi i kërkueses se KAGJL-ja ka keqinterpretuar nenin 36 të KPC-së, nuk është i bazuar.

11. ***Subjekti i interesuar***, shoqëria "Global Enterprise Group" sh.p.k., ka prapësuar si vijon:

11.1. KAGJL-ja ka dhënë një vendim të drejtë në harmoni me të gjitha provat shkresore, pretendimet dhe prapësimet e palëve ndërgjyqëse. Ndryshe nga sa pretendon kërkuesja, çështja civile ishte pushuar nga gjykata 10 ditë përpara se MEI të nxirrte aktet administrative, përkatësisht urdhrat nr. 589/2013 dhe nr. 590/2013. Këto dy akte janë nxjerrë nga organi kompetent bazuar në ligj dhe në prova shkresore.

11.2. Në çështjen konkrete, KAGJL-ja është shprehur për të gjitha kërkimet e parashtruara nga kërkuesja në respektim të neneve 6 dhe 28 të KPC-së. Pretendimi i kërkueses se Gjykata e Lartë ka keqinterpretuar nenin 36 të KPC-së, nuk është i bazuar.

12. ***Subjekti i interesuar***, Avokatura e Shtetit, ka parashtruar si më poshtë:

12.1. Pretendimi i kërkueses për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj nuk është i bazuar. KAGJL-ja nuk ka administruar prova të reja dhe nuk ka bërë rivlerësim të provave ekzistuese. Ky kolegj ka vepruar në përputhje me kompetencat e tij ligjore, në referim të dispozitave përkatëse procedurale dhe atyre të ligjit nr. 49/2012.

12.2. Ndryshe nga sa pretendon kërkuesja, vendimi i Gjykatës së Lartë i ka përmbushur standardet e përcaktuara nga jurisprudenca kushtetuese në lidhje me parimin e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Ai përmban të gjitha elementet që duhet të ketë një vendim gjyqësor i arsyetuar.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkueses

13. Gjykata vëren se kërkuesja legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si edhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur në Gjykatë brenda afatit ligjor të përcaktuar në nenin 50/4 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

14. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae*, vërehet se kërkuesja ka ngritur pretendime të cilat *prima facie* lidhen me të drejtën kushtetuese për një proces të rregullt ligjor. Në vijim janë shqyrtuar sipas radhës së mësipërme pretendimet e kërkueses.

B. Për pretendimin e cenimit të parimit të gjykatës së caktuar me ligj dhe parimit të disponibilitetit në gjykim

15. Kërkuesja ka pretenduar se KAGJL-ja ka cenuar parimin e gjykatës së caktuar me ligj, pasi vendimi nuk është mbështetur në provat e administruara gjatë gjykimit në shkallë të parë dhe në apel. Sipas saj, procedura e konkurrimit për marrjen e lejes minerare, së cilës i është referuar në vendim KAGJL-ja, nuk përmendet fare si provë e administruar gjatë gjykimeve në shkallët më të ulëta. Po ashtu, KAGJL-ja ka tejkaluar kufijtë e kërkesave të parashtruara nga palët, në shkelje të

parimit të disponibilitetit dhe në kundërshtim me parimet mbi të cilat mbështetet procesi gjyqësor civil dhe administrativ. Po sipas saj, ministri nuk kishte të drejtë të nxirrte urdhrat nr. 589/2013 dhe nr. 590/2013, pasi urdhrat e mëparshëm nr. 1003/2011 dhe nr. 1004/2011 ishin në proces shqyrtimi gjyqësor në Gjykatën e Apelit dhe asnjë organ i administratës nuk kishte të drejtë të shqyrtonte një mosmarrëveshje civile që ishte duke u shqyrtuar nga gjykata, bazuar në nenin 36 të Kodit të Procedurës Civile (KPC).

16. Gjykata ka vlerësuar se një nga elementet e procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, është dhe shqyrtimi i çështjes nga një *"gjykatë e caktuar me ligj"*. Ky element karakterizohet, në sensin material, nga funksioni gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve nga organe të ngarkuara me ligj për të dhënë drejtësi. Përveç këtij kushti, këto organe duhet të shqyrtojnë dhe të vendosin për çështje që janë në kompetencë të tyre gjatë një procesi të zhvilluar mbi një procedurë ligjërisht të përcaktuar dhe në pajtim me rendin juridik. E drejta e çdo pale për t'u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente dhe të caktuar me ligj nënkupton që gjykata të ketë juridiksion për të gjykuar çështjen dhe që kompetenca për të vendosur për të t'i jetë njohur nëpërmjet ligjit *(shih vendimin nr. 40, datë 25.6.2015, të Gjykatës Kushtetuese)*.

17. Në kuptim të funksionit rishikues të Gjykatës së Lartë, të sanksionuar në nenin 141 të Kushtetutës, Gjykata ka vlerësuar se kompetenca e saj për shqyrtimin e çështjeve nuk bazohet mbi të njëjtat dispozita procedurale, të cilave u referohen gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit. Në nocionin kushtetues të rishikimit futet, në radhë të parë, shqyrtimi i rekurseve për pretendimet e shkeljes të ligjit material ose procedural, gjë që përbën funksionin kryesor të Gjykatës së Lartë (*shih vendimet nr. 11, datë 3.3.2016; nr. 27, datë 24.6.2013; nr. 7, datë 9.3.2009; nr. 31, datë 1.12.2005, të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Sipas jurisprudencës kushtetuese, procesi nuk konsiderohet i parregullt, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, kur Kolegji i Gjykatës së Lartë, mbi të njëjtat prova e fakte të vlerësuara në gjykimet e mëparshme, vendos të prishë vendimet dhe ta zgjidhë vetë çështjen, për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit (*shih vendimet nr. 27, datë 24.6.2013; nr. 7, datë 9.3.2009, të Gjykatës Kushtetuese*). Në ushtrimin e funksionit të saj si gjykatë e ligjit, Gjykata e Lartë mund të vendosë për themelin e çështjes vetëm nëse mosmarrëveshja mund të zgjidhet në bazë të të njëjtave fakte dhe prova të vlerësuara nga gjyqtari i faktit dhe që përbëjnë bazën e vendimit në të cilin është bërë një interpretim i gabuar i ligjit. Kontrolli i saj duhet të fokusohet vetëm në drejtim të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankimuara, pra mbi mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat e faktit. Gjykata e Lartë nuk mund të anashkalojë apo të lërë pa vlerë prova që janë shqyrtuar dhe vlerësuar nga gjykatat e faktit, si dhe nuk mund të pranojë prova të cilat nuk janë administruar gjatë gjykimit në fakt. Gjykata ka theksuar se kusht për dhënien nga Gjykata e Lartë të një vendimi mbi themelin e çështjes, në kuptim të nenit 485 të KPC-së, është që jo vetëm të mos nevojitet administrimi i provave të reja, por edhe që provat e administruara të jenë shqyrtuar dhe vlerësuar në mënyrë të mjaftueshme nga gjyqtari i faktit (*shih vendimin nr. 27, datë 24.6.2013, të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Duke iu referuar çështjes konkrete, Gjykata vëren se KAGJL-ja ka arsyetuar se "*vendimet e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe Gjykatës Administrative të Apelit janë marrë në zbatim dhe interpretim të gabuar të ligjit dhe si të tilla ato janë të cenueshme. Urdhrat nr. 589, datë 21.6.2013, dhe nr. 590, datë 21.6.2013, të ministrit të Energjisë dhe Industrisë, janë akte administrative të nxjerra në bazë e për zbatim të ligjit, në përputhje me kompetencat ligjore që ligji i njeh atij organi administrativ. Aktet administrative të kundërshtuara nga pala paditëse janë marrë në zbatim të nenit 102/4 të Kushtetutës, ligjit nr. 10304/2010 "Për sektorin minerar në RSH", nenit 121 e vijues të K. Pr. Administrative, si dhe rekomandimeve të DKBAA, dërguar me raport kontrollin nr. 1657, datë 16.5.2013. Aktet 589 dhe 590, të cilat kundërshtohen nga paditësi, nuk janë akte absolutisht të pavlefshme, pasi janë nxjerrë nga organi kompetent në zbatim të ligjit dhe duke respektuar procedurën ligjore*". Nga sa më sipër, Gjykata çmon se KAGJL-ja i ka analizuar dhe vlerësuar vendimet e gjykatave më të ulëta në vështrim të dispozitave ligjore të zbatueshme në çështjen konkrete, duke

arritur në përfundimin se ato janë marrë në zbatim dhe interpretim të gabuar të ligjit. Nga vlerësimi në tërësi i vendimit objekt shqyrtimi, duke u bazuar në kompetencat që Gjykata e Lartë gëzon si gjykatë ligji, Gjykata nuk gjen elemente të cenimit të parimit të gjykatës së caktuar me ligj.

20. Në lidhje me pretendimin për cenimin e parimit të disponibilitetit, Gjykata rithekson se parimi i disponibilitetit është një parim i rëndësishëm procedural civil, i cili parashikohet në nenin 2 të Kodit të Procedurës Civile. Pretendimet që kanë të bëjnë me shkeljen e këtij parimi janë trajtuar gjerësisht në jurisprudencën kushtetuese, si pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, e janë analizuar bashkërisht edhe në funksion të standardeve të tjera kushtetuese që karakterizojnë këtë të drejtë. E drejta për të disponuar mbi objektin e padisë është një e drejtë e paditësit, i cili e ushtron atë duke bërë ndryshimet, shtesat apo pakësimet e objektit të padisë sipas interesave të tij. Gjykata nuk mund të diktojë objektin e padisë dhe as të pengojë paditësin në ushtrimin e së drejtës për të disponuar mbi këtë objekt (*shih vendimin nr. 6, datë 15.4.2005, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka vlerësuar se një kërkues nuk legjitimohet *ratione personae* në ngritjen e pretendimit për cenimin e parimit të disponibilitetit në rast se objekti i gjykimit përcaktohej nga një palë tjetër (*shih vendimet nr. 16, datë 19.4.2013; nr. 7, datë 9.3.2009; nr. 6, datë 15.4.2005; nr. 20, datë 2.7.2003, të Gjykatës Kushtetuese).*

21. Në çështjen konkrete, Gjykata vëren se urdhrat nr. 1003/2011 dhe nr. 1004/2011, të nxjerra nga METE-ja, janë kundërshtuar në gjykatë nga subjekti i interesuar, shoqëria "Global Enterprise Group" sh.p.k. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 6505, datë 11.6.2013, ka vendosur pushimin e gjykimit për mosparaqitje të paditësit, shoqërisë "Global Enterprise Group" sh.p.k. Në këtë proces kërkuesja ishte thirrur në cilësinë e personit të tretë. Vendimi i pushimit të gjykimit është ankimuar nga kërkuesja, e cila më pas ka hequr dorë nga ankimi i ushtruar prej vetë asaj. Mbi këto fakte, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 3321, datë 9.9.2014, ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes. Në këto rrethana, Gjykata çmon se pretendimet e kërkueses në lidhje me cenimin e parimit të disponibilitetit, si rrjedhojë e nxjerrjes së akteve administrative në shkelje të nenit 36 të KPC-së gjatë kohës që çështja ishte në shqyrtim gjyqësor, nuk argumentojnë cenimin e këtij standardi. Për më tepër, ato kanë të bëjnë me një proces gjyqësor, ku objekti i gjykimit përcaktohej nga një palë tjetër.

22. Në vështrim të standardeve të mësipërme kushtetuese dhe nga aktet e administruara, në vlerësimin e Gjykatës nuk rezulton që KAGJL-ja të jetë shprehur tej objektit të padisë apo tej shkaqeve të paraqitura në rekurset e bëra nga palët në gjykim. Nisur nga ky konstatim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkueses për cenimin e parimit të disponibilitetit në gjykim është i pabazuar.

23. Nisur nga analiza dhe standardet kushtetuese të mësipërme, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkueses për cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj dhe të parimit të disponibilitetit në gjykim janë të pabazuara dhe nuk duhen pranuar.

C) Për pretendimin e cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor

24. Kërkuesja ka pretenduar se është cenuar standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor, pasi vendimi i KAGJL-së është i paqartë dhe jologjik. KAGJL-ja nuk ka zbatuar dispozitat ligjore që ishin në fuqi në kohën kur janë nxjerrë lejet minerare për kërkuesen dhe subjektin e interesuar, "Global Enterprise Group" sh.p.k. Ajo ka mbajtur qëndrime kontradiktore në vendim, pa përmendur dispozitat ligjore ku referon paligjshmërinë e akteve administrative për të cilat shprehet në vendim. KAGJL-ja, megjithëse ka konkluduar se akti i zgjerimit të lejes minerare është i pavlefshëm, nuk përcakton nëse jemi përpara pavlefshmërisë absolute apo relative. Kolegji nuk ka mbajtur parasysh faktin se akti administrativ i revokimit është bërë jashtë afatit 3-vjeçar të parashikuar në KPA. Sipas kërkueses, vendimi i KAGJL-së është jologjik, pasi i referohet një ligji që nuk ishte i zbatueshëm në rastin konkret.

25. Gjykata ka theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga

nenet 42 dhe 142/1 të Kushtetutës, si dhe nga neni 6 i KEDNJ-së, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe ju jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet edhe vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë *(shih vendimin nr. 18, datë 15.3.2016, të Gjykatës Kushtetuese).*

26. Në jurisprudencën e saj, Gjykata ka vlerësuar domosdoshmërinë e arsyetimit të vendimeve gjyqësore, penale apo civile, si një garanci për procesin ligjor. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Vendimi mund të kontrollohet nga një gjykatë më e lartë sipas procedurave përkatëse dhe që kjo të jetë e mundur, duhet bërë arsyetimi i vendimit, në të cilin gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm, që e kanë çuar në bërjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive. Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Ato përmbledhin dhe finalizojnë përfundimisht qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim *(shih vendimin nr. 18, datë 15.3.2016, të Gjykatës Kushtetuese).*

27. Gjithsesi, Gjykata e ka vlerësuar zbatimin e këtij parimi rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre. Ajo ka verifikuar nëse vendimi i kundërshtuar është logjik, ka kundërthënie, përmban referenca në ligjin e zbatueshëm dhe nëse respekton të gjitha elementet e sipërpërmendura. Detyrimi i gjykatave për të respektuar këtë standard ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete dhe natyrës së vendimit, dhe masa e arsyetimit varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimin nr. 25, datë 10.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Në këtë kontekst, Gjykata ka theksuar se ajo e vlerëson arsyetimin e një vendimi gjyqësor vetëm në kuadrin e përmbushjes ose jo të standardeve të mësipërme, pasi nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata për zgjidhjen e çështjes së themelit. Kjo mbetet detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Ndërsa në aspektin e kontrollit kushtetues, Gjykata verifikon nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo kriteret e përcaktuara më sipër, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar *(shih vendimin nr. 18, datë 15.3.2016, të Gjykatës Kushtetuese).*

29. Duke iu kthyer çështjes konkrete, nga përmbajtja e vendimit të KAGJL-së nuk rezulton që ky vendim jetë jologjik, të ketë kundërthënie, të mos ketë referencë në ligjin e zbatueshëm dhe të mos respektojë elementet e trajtuara nga jurisprudenca kushtetuese e sipërcituar. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkueses për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është i pambështetur.

30. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkueses për cenim të procesit të rregullt ligjor janë të pabazuara dhe nuk duhen pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren

Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Fatmir Hoxha, Gani Dizdari, Besnik Imeraj, Fatos Lulo, Vitore Tusha

Anëtar kundër: Vladimir Kristo